



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR RIKONSTRUKSIONIN E SHKOLLËS “DOM NIKOLL
KAÇORRI”**

I mbajtur më 30.07.2025, në orën 15:00, në dëgjuesën me prindër dhe mësues të nxënësve të shkollës “Dom Nkoll Kaçorri”, të Njesis Administrative Paskuqan, në lidhje me rikonstruksionin e shkollës “Dom Nikoll Kaçorri”.

Takimi u zhvillua në Sallën e Këshillit, Bashkia Kamëz.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
- Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe;
- Administratori i Njesis Administrative Paskuqan, z. Eduard Bodini
- Këshilli Bashkiak;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Prindër dhe mësues të nxënësve të shkollës “Dom Nikoll Kaçorri”;
- Qytetarë të Kamzës.

Konsultimi u hap nga Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe, e cila pasi falenderoi kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Rakip Sulin dhe të gjithë të pranishmit, u ndal tek arsimi dhe sfidat e tij: “Arsimi në Kamëz ka kaluar nëpër sfida dhe transformime të shumta. Të gjithë mësuesit dhe prindërit e pranishëm e dinë shumë mirë se si ka qenë situata ndër vite, sidomos ata prej nesh që kemi qenë pjesë e sistemit arsimor për një kohë të gjatë. Falë vizionit, vullnetit dhe përkushtimit të kryetarit Rakip Suli, sot shkollat e Kamzës janë shembull i një transformimi të suksesshëm. Që në fillim të mandatit të tij, z. Suli është treguar i vendosur për të investuar në infrastrukturën arsimore, një vendim i domosdoshëm dhe i drejtë.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe edhe me shkollën “Dom Nikoll Kaçorri”, e cila tashmë po merr pamjen e një institucioni arsimor me kushte moderne dhe ambiente dinjitoze, ashtu siç i takon nxënësve dhe mësuesve që punojnë e mësojnë aty”, u shpreh znj. Sulçe.

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili falënderoi të pranishmit dhe gjithë stafin mësimor për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë ndër vite.

Në fjalën e tij, z. Suli u shpreh: “Jam i nderuar që ndodhem sot përpara jush, ballëllartë për të gjitha investimet që kemi realizuar në fushën e arsimit. Që në ditën e parë kur mora detyrën si kryetar i Bashkisë Kamëz, isha i vendosur që prioriteti im të ishte arsimi dhe infrastruktura arsimore. Arsimi është themeli i çdo shoqërie dhe baza për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Ju i mbani mend mirë se në çfarë gjendje ishin shkollat në Kamëz: pa standarde, pa sistem ngrohjeje, me ambiente të papërshtatshme. Ju, mësuesit, por dhe prinderit kur i dërgonit fëmijet në shkollë e keni jetuar atë realitet çdo ditë.

Në këto vite, kemi investuar në 40 objekte arsimore, shkolla të ndërtuara nga e para, si dhe kopshte e çerdhe të standardeve më të larta. Jam krenar që sot Kamza është një ndër qytetet me shkollat më të bukura dhe moderne në Shqipëri.

Natyrisht, edhe për shkollën “Dom Nikoll Kaçorri” është hartuar projekti i rikonstruksionit të plotë. Nuk mund të ndodhte ndryshe edhe kjo shkollë do të bëhet pjesë e standardit të ri arsimor që po ndërtojmë në qytetin tonë.

Sot, më shumë se kurrë, jam i lumtur që mund të flas me fakte për një infrastrukturë arsimore tërësisht të transformuar. Premtimi që kam dhënë ditën që mora detyrën si kryetar bashkie është sot realitet. Dhe ju, që jeni këtu, e dëshmoni këtë çdo ditë me punën dhe përkushtimin tuaj”, theksoi kryetari Suli.

Më pas Kryetari z. Rakip Suli, prezantoi projektin e rikonstruksionit të shkollës “Dom Nikoll Kaçorri”.

Projekti i rikonstruksionit të shkollës “Dom Nikoll Kaçorri”

- Punime tarrace (hidroizolim, termoizolim, së bashku me hulluqet dhe kasetat e shkarkimit)
- Rikonstruksion i shtresave të dyshemesë.
- Punime suvatimi në ambientet e brendshme: mure, tavane me gips dhe patinime.
- Punime dyer-dritare, të brendshme dhe të jashtme, dhe vetrata të gjera.
- Punime sistemimi të territorit të shkollës, ku përfshihen fusha volejball-basketboll.
- Punime riparimi të sistemit elektrik të shkollës.
- Rikonstruksion i tualeteve të shkollës.
- Instalimi i sistemit ngrohës.
- Rikonstruksion i fasadës me sistem kapot.

Gjatë takimit, secilit pjesëmarrës iu dha mundësia dhe koha e nevojshme për të shtruar pyetje dhe për të dhënë sugjerime në lidhje me projektin e rikonstruksionit të shkollës "Dom Nikoll Kaçorri".

Takimi u përmbyll me një falënderim të përzemërt nga kryetari i Bashkisë, z. Rakip Suli, i cili siguroi të pranishmit se çdo sugjerim i dhënë do të merret parasysh dhe do të vlerësohet për t'u përfshirë në fazat e mëtejshme të zbatimit të projektit.







